



Mjafton të nënshkruani
me palën,
të tjerat i bëjmë ne!



anti KORRUPSION

ORGAN
I SHOQATES
ANTI-KORRUPSION
SHQIPTARE

Info.antikorruptioni@gmail.com <https://antikorrupsion.com/>

Adresa e re: Ruga "5 Maji" Ish-Ndermarrja Kimike, Tiranë Nr. kontakti: +355692020512

Lista e zeze për gjyqtarë e prokurorë

Shpesh ndodh që ata krijojnë lidhje të reja dhe formojnë familje të tjera, duke sjellë fëmijë që mund të mbeten pa regjistrim të saktë në regjistrat shtetërorë. Ky fenomen është një pasojë direkte e procedurave të ngadalta dhe pengesave ligjore që ndodhin gjatë periudhës së pritjes për divorc



Nga Av. Ndue Pjetra

>>> Faqe 2



PROBLEMORE

Policia, "gjueti shtrigash", kontrolli kufitar që po shkel liritë qytetare

>>> Faqe 6

FAKTE

Statuti i Drishtit. Si përfundoi në ankand ky dokument me rëndësim historike?

>>> Faqe 7

TRADITA

Kodi i Lek Dukagjinit, më i vjetri në Evropë

>>> Faqe 12-13

PROFIL

Mrika, malësorja që mori gjakun burrit, historia që u bë pjesë e një libri Best Seller në vitin 1909

>>> Faqe 14

BOTIMI

"Shqipëria një histori e mentaliteti juridik", e drejta jonë shekullore e të jetuarit fisnikërisht në drejtësi

>>> Faqe 10-11



Av. Nertila Bejo

Problematikat lidhur me vonesat e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit


>>> Faqe 3



Nga Klodjan Reçi

Sfida për të zhdukur një herë e mirë avokatët mashtrues

>>> Faqe 4



As. Sara Demrozi

Rrjeti social, Tik Tok: Erdhi ora për ndryshim dhe spekulimet mediatike

>>> Faqe 5



Nga Shkëlqim Kokona

Lidhur me Kushtetutën e Shtetit të Parë Shqiptar, Principatën e Arbërit, i quajtur Kanuni i Skënderbeut

>>> Faqe 8-9

Nëse ka mosmarrëveshje mbi ndarjen e pasurisë ose kujdestarinë e fëmijëve, divorci duhet të vazhdojë përmes gjykatës, por ky proces do të duhej të ishte i shpejtë dhe i drejtpërdrejtë, për të shmangur vonesat dhe pasojat e tjera të mundshme. Nëse reforma e tillë do të kalonte, do të krijonte një sistem më efikas dhe të drejtë për çiftet që kërkojnë një ndarje të ndershme.

Lista e zeze për gjyqtarë e prokurorë

Shpesh ndodh që ata krijojnë lidhje të reja dhe formojnë familje të tjera, duke sjellë fëmijë që mund të mbeten pa regjistrim të saktë në regjistrat shtetërorë. Ky fenomen është një pasojë direkte e procedurave të ngadalta dhe pengesave ligjore që ndodhin gjatë periudhës së pritjes për divorc

Av. Ndue Pjetra

Në Shqipëri, drejtësia është bërë sinonim i pritjes dhe zhgënjimit. Rastet e divorceve, të cilat në shumicën e vendeve të zhvilluara zgjidhen brenda disa muajve, në vendin tonë mund të zgjasin më shumë se 5 deri në 6 vite. Një periudhë kohore absurde, që për shumicën e njerëzve nënkupton humbjen e viteve më të rëndësishme të jetës, të mbërthyer në një proces gjyqësor pa fund. Kjo është historia e përditshme e dhjetëra qytetarëve të zakonshëm, të cilët përballen me burokracinë dhe mungesën e eficiencës në gjykatat shqiptare.

Divorci si një Luftë e Pafundme
Një martesë e përfunduar është një kapitull i mbyllur në jetën e shumë njerëzve. Por në Shqipëri, për ta mbyllur atë edhe në aspektin ligjor, duhet të kalosh një rrugë të gjatë plot me pengesa burokratike dhe procedurale që duket sikur nuk kanë fund. Shumë çifte që kërkojnë një divorc shndërrohen në viktima të një sistemi të drejtësisë të ngadalshëm, të mbingarkuar dhe shpesh të paaftë për të zgjidhur çështjet në kohë të arsyeshme.

Në vend që të përballen me një procedurë të drejtë dhe të shpejtë, qytetarët shohin se çdo seancë shtyhet në mënyrë të pashmangshme për shkak të mungesës së gjyqtarëve, mbivendosjes së çështjeve dhe një morie burokracie të panevojshme.



Humbja e Jetës në Pritje

Kur një proces divorci zgjat më shumë se gjysma e një dekade, çfarë mbetet nga jeta e një individi? Pritja për një vendim gjyqësor nuk është vetëm një pengesë ligjore, por një pengesë që shkatërron të ardhmen. Shumë individë përballen me bllokim emocional, pa mundur të rifillojnë jetën personale apo të ndërtojnë një marrëdhënie të re, për shkak të statusit të paqartë ligjor.

A është e drejtë të presësh gjashtë vite për të marrë fund një martesë që në realitet ka përfunduar prej kohësh? Përgjigjja është e qartë: Jo! Në asnjë vend demokratik nuk është e pranueshme që qytetarët të humbasin vite nga jeta e tyre për

shkak të një drejtësie të bllokuar.

Pasojat e Rënda mbi Fëmijët

Pasojat më të dhimbshme të kësaj vonese të padrejtë i vuajnë fëmijët. Në shumë raste, për shkak të një vendimi të vonuar për kujdestarinë, ata mbeten të bllokuar në mes të një konflikti që mund të zgjidhet vetëm nga gjykata. Pasiguria që krijohet në jetën e tyre është e pallogaritshme dhe ndikimi psikologjik i kësaj situatë mund të zgjasë për vite me radhë, duke u reflektuar edhe në të ardhmen e tyre.

Reforma që Nuk Po Vjen Kurrë

Pavarësisht premtimeve të shumta për reforma në drejtësi, realiteti tregon se sistemi vazhdon të lëngojë nga e njëjta sëmundje: vonesa

të pajustificueshme, mungesë përgjegjësie dhe mbi të gjitha, një mosrespektim flagrant i kohës dhe dinjitetit të qytetarit. Çështjet e martesave duhet të kenë përparësi dhe të trajtohen me shpejtësi, pasi çdo ditë vonese përkthehet në jetë të humbur.

Në fund të fundit, drejtësia që vonon, është drejtësi që mohon. Dhe në Shqipëri, drejtësia po mohohet çdo ditë për ata që presin një vendim që nuk duket se do të vijë ndonjëherë.

Kjo nuk është thjesht një çështje gjyqësore, është një çështje njerëzore. Pritja prej 6 vitesh për një divorc është një tragjedi e heshtur që duhet të marrë fund.

Mjaft më me drejtësi të vonuar!

Problematikat lidhur me vonesat e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit



Av. Nertila Bejo

“E drejta për një proces të rregullt”, përcakton shprehimisht se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat / detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”

Një nga problematikat kryesore që haset në sistemin gjyqësor janë dhe vonesat në proceset gjyqësore ku më të spikatura janë vonesat e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit. Këto vonesa në proceset gjyqësore sjellin pasoja të rëndësishme për ata që i përket palëve të përfshira duke krijuar tek ata probleme financiare, moszgjidhje të problemit në kohë dhe stresin emocional. Ka disa faktorë të cilët kanë ndikuar dhe po ndikojnë në këtë problem dhe këto janë numri i lartë i çështjeve që zhvillohen në Gjykatën e Apelit. Në bazë të praktikës së hasur në çështjet gjyqësore ka procese gjyqësore që kanë mbi 3 vjet dhe ende nuk kanë nxjerrë një datë për zhvillimin e procesit dhe zgjidhjen e kësaj çështje. Disa nga pasojat që sjellin vonesat në Gjykatën e Apelit janë:

1. Shkelja e të drejtave themelore të njeriut duke e bërë të pamundur që individët të hasen me një proces të rregullt ligjor dhe efikas, pasi bazuar dhe në Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut, në nenin 6 të saj përcaktohet: “E drejta për një proces të rregullt”, përcakton shprehimisht se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe

e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat / detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.
2. Pamundësi financiare, pasi këto vonesa sjellin kosto financiare për individët duke përfshirë kostot për procesin gjyqësor dhe për më tepër ka individ të cilët e kanë të pamundur ti mbulojnë nga ana financiare të gjitha problematikat

gjyqësore.

3. Pengesë për zgjidhjen e konflikteve duke krijuar moszgjidhje të konfliktit dhe duke i krijuar palëve ndërce për problematikën e hasur.
4. Mungesa e besimit në sistemin gjyqësor, krijon tek palët ndjenjë pasigurie për sistemin gjyqësor duke mos krijuar besimin se sistemi gjyqësor është një sistem i efikas pasi këto vonesa janë të pranishme gjatë gjithë procesit gjyqësor, jo vetëm në nisje të tij por

edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Rruga më e mirë për zgjidhjen e këtyre problematikave është adresimi në institucionet përkatëse që të punojnë për të përmirësuar efikasitetin në proceset gjyqësore duke investuar në burime pasi mungesa e gjtqarëve është faktori kryesor në ato që këtij sistemi i mungojnë në mënyrë, që të bëhet reduktimi i këtyre vonesave dhe individëve tu jepet zgjidhje për çështjet përkatëse.



Sfida për të zhdukur një herë e mirë avokatët mashtrues



Klodjan Reçi

30 vitet e fundit në tranzicionin Shqiptar sigurisht që ka ndikuar në mbarëvajtjen e këtij profesioni fisnik që në themel ka për qëllim, të mbrojë interesat e palës më të dobët në raport me fuqinë absolute të pushtetit shtetëror

Shpesht e kemi dëgjuar rëndom, shprehjen se: 'Avokatët në Shqipëri janë mashtrues' por të ndalemi në shkaqet përse është krijuar ky zhargon dhe mentalitet në mbarë opinionin publik, duke i veshur kështu, një 'togë' e cila nuk përfaqëson misionin dhe punën e një avokati.

30 vitet e fundit në tranzicionin Shqiptar sigurisht që ka ndikuar në mbarëvajtjen e këtij profesioni fisnik që në themel ka për qëllim, të mbrojë interesat e palës më të dobët në raport me fuqinë absolute të pushtetit shtetëror. Nuk mund të mbetet pa vëmendje të veçantë se aktualisht sfidat më të mëdha në kontekstin Shqiptar mbetet respektimi i të drejtave të njeriut.

Si asnjëherë më parë në historinë e shtetit shqiptar, sistemi i drejtësisë gjendet i paralizuar, për shkak të politikave për reformimin e sistemit duke ndikuar në performancën e të gjithë aktorëve.

Nisur nga ky realitet i papranueshëm, praktikisht ushtrimi i profesionit të avokatit dhe të drejtave të tyre, por edhe mbrojtjen e integritetit të veprimtarisë së avokatit pranë nga çdo organ shtetëror.

Hulumtimet tregojnë se Avokatët në Shqipëri përballen me një sërë sfidash në profesionin e tyre, të cilat mund të grupohen në disa kategori kryesore:

1. Kuadri ligjor dhe reformat

Prej 20 vitesh që me fillimin e procesit të përafrimit të legjislacionit Shqiptar me direktivat e

Bashkimit Evropian kanë sjellë ndryshime të shpeshta ligjore të cilat kanë krijuar një pasiguri duke e bërë të vështirë edhe për avokatët për të qenë të përditësuar me to e rrjedhimisht ka sjellë edhe ndryshime të praktikës ligjore si rezultat i këtyre ndryshimeve të shpeshta ligjore

2. Çështjet e sistemit gjyqësor

Të paktën prej rreth 6 vitesh qytetarëve Shqiptarë vijojnë përballjen me vonesat të paarsyeshme në zgjidhjen e çështjeve duke krijuar një stok në gjykatat e të gjitha niveleve të cilat kërkojnë edhe vite 5 vite të tjera duke krijuar një shtesë artificiale çështjesh. Kjo vonesë e sistemit gjyqësor e diktuar nga një sërë faktorësh përveçse është kthyer në një sfidë me kohën ka sjellë dhe një frustrim tek avokatët të gjendur nën presionin e vazhdueshëm të klientëve të cilët kërkojnë zgjidhjen sa më parë të çështjeve të tyre.

3. Qasja në drejtësi

Shpesh qytetarët gjenden të pashpresë për të siguruar një avokat të zgjedhur dhe profesional me kapacitete të mira për shkak se qasen dot me sistemin për shkak të mundësive financiare e për rrjedhim edhe të drejtën e tyre për të

marrë shërbimet ligjore adekuate. Ky kufizim i burimeve ka krijuar për shumë qytetarë një sfidë e cila përcillet edhe në punën e avokatëve të cilët të gjendur përpara mungesës së aftësive paguese të qytetarëve ndikon në cilësinë e dhënies së shërbimit. Aktualisht kuadri ligjor për ofrimin e shërbimit të mbrojtjes juridike të paguar nga shteti nuk është në nivelin e tregut dhe nuk përfaqësojnë aktualitetin.

drejtat ligjore dhe rolin e avokatëve, duke çuar në shfrytëzimin e pamjaftueshëm të burimeve ligjore.

4. Zhvillimi profesional

Që nënkupton edukimin e vazhdueshëm ligjor për të krijuar mundësi sa më të mira për specializim nisur nga konceptet e reja juridike dhe institutet e së drejtës procedurale, ka penguar rritjen profesionale të avokatëve nisur edhe nga mungesa e kapaciteteve burimore të Dhomës së Avokatisë. Kjo gjendje e krijuar sjell natyrisht një sfidë në punën e avokatit pasi nuk gjenden në të njëjtin nivel trajnimi vazhdueshëm me konceptet e reja juridike.

Është shumë interesant fakti se

sfidat kryesore të punës vijnë nga intelektualë, të shkolluar, dhe fort mirë e dinë çka do të thotë ligji e këto janë probleme të një mentaliteti, i cili akoma është konservator tregon se shoqëria Shqiptare ende nuk është e përgatitur për të kërkuar atë çfarë avokati ka në misionin e tij, realizimin e një mbrojtjeje dhe përfaqësimi juridik dhe jo të shikohet si ndërmjetësi i pazareve në zgjidhjen e problemeve.

Pritshmëritë e afërta janë që të krijohet një mjedis normal për avokatët e ndershëm nisur edhe nga ndryshimet rrënjësore të viteve të fundit me shpresën se respektimi i të drejtave të njeriut dhe garancive procedurale nuk do të konsiderohen si një formalitet por si një gur themeli pa të cilën nuk mund të krijohet një shoqëri moderne. Ndryshimi i mentalitetit kërkon kohë dhe ndër kontribuuesit më të mëdhenj është media për të raportuar gjithçka ndodh dhe bëjnë avokatë të papërgjegjshëm në ushtrimin e detyrës së tyre.

Thirrja për më shumë të drejta dhe transparencë do t'i japë fund njëherë e mirë shprehjes cliché Avokatët në Shqipëri janë mashtrues'.




As. Sara Demrozi

Tik Tok: Erdhi ora për ndryshim

Sistemi gjyqësor ka dështuar të arrijë në një përfundim objektiv për këtë çështje. Prokuroria, pas hetimeve, nuk ka arritur të mbledhë prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzat. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndaluar gjykatën, e cila ka përdorur disa fakte rrethanore për të vendosur dënimin e individëve të akuzuar

Kronika e Një Rasti Kontrovers: Arrestimi i Natasha R. dhe Djalit të Saj Armand për Abuzim Mediatik dhe Drejtësor

Në një ngjarje që ka tronditur opinionin publik, një familje nga Saranda, në rastin konkret Natasha R. dhe djali i saj Armandi, u arrestuan vitin e kaluar nën akuzën se kishin nxitur fëmijën e mitur (djali Armandit) të përdorte një fjalor agresiv dhe të papërshtatshëm, duke e publikuar këtë video në rrjetin social TikTok. Akuza të tjera përfshinin përdorimin e fëmijës për qëllime financiare dhe abuzim psikologjik.

Pas arrestimit, çështja u bë menjëherë publike dhe mediat raportuan për këto akuza, duke krijuar një valë reagimesh të forta dhe kritika ndaj familjes. Megjithatë, hetimet dhe aktet e ekspertimit nga prokuroria nuk arritën të vërtetonin asnjë nga këto akuza. Përkundrazi, rezultoi se ato ishin shpifje të orkestruara nga ish-bashkëshortja e Armandit, që kishte si qëllim të dëmtonte reputacionin e tij dhe të familjes.

Abuzimi Mediatik dhe Perceptimi i Gabuar

Ky rast ka nxjerrë në pah një problem të thellë lidhur me mënyrën se si mediat dhe opinionet publike reagojnë ndaj çështjeve të ndjeshme. I gjithë procesi i ndjekjes penale dhe publikuar masivisht ka theksuar se shpeshherë, pa pasur prova konkrete, mediat dhe shoqëria krijojnë perceptime të gabuara mbi individët. Ky është një shembull i qartë i mënyrës sesi abuzimi mediatik mund të ndikojë në jetën e qytetarëve të zakonshëm.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se gazetaria dhe media shpesh abuzojnë me titujt për të tërhequr vëmendjen, pa u munduar të verifikojnë nëse informacioni është i vërtetë. Në këtë rast, Natasha R. e ka paguar një çmim të lartë për karakterin e saj të hapur



dhe flamboyant. Ajo jo vetëm që u gjykua nga media, por edhe nga vetë sistemi i drejtësisë.

Një Drejtësi e Bazuar në Perceptim dhe Jo në Fakte

Sistemi gjyqësor ka dështuar të arrijë në një përfundim objektiv për këtë çështje. Prokuroria, pas hetimeve, nuk ka arritur të mbledhë prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzat. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndaluar gjykatën, e cila ka përdorur disa fakte rrethanore për të vendosur dënimin e individëve të akuzuar.

Pavarësisht qëndrimit të Natasha R. në arrest shtëpiak dhe Armandit në burg, provat dhe hetimet e mëtejshme nuk mbështesin dënimin e tyre. Ky rast është një shembull i një sistemi që ndonjëherë vendos të gjykojë bazuar në perceptimin

publik dhe jo në fakte të vërtetuara. **Rreziku i Bombardimit Mediatik dhe Pasojat për Individët**

Ky rast ka nxjerrë në pah rrezikun e bombardimit mediatik, i cili shpesh përdoret për të tërhequr vëmendjen, dhe ndonjëherë pa asnjë përpjekje për të verifikuar informacionin. Më shumë se kaq, ky rast ka shkaktuar një shqetësim të madh mbi funksionimin e drejtësisë dhe ndikimin që ka media në procesin gjyqësor. Rasti i Natasha R. dhe Armandit tregon se ndonjëherë, për të arritur vëmendjen mediatike, individët bëhen viktimat e një sistemi që nuk i jep rëndësi provave dhe fakteve, por i lejon që të gjykohen nga perceptimi.

Sistemi gjyqësor, sidomos gjyqtarët e rinj, shpesh nuk arrijnë të arrijnë në një përfundim të pavarur dhe objektiv, për shkak të frikës nga gabimet. Për ta, është më e thjeshtë

të lejojnë që njerëzit të vuajnë një dënim të padrejtë, sesa të krijojnë aftësitë e nevojshme për të marrë vendime të sakta dhe të drejtë.

Përfundim: Nevoja për Reformë dhe Përgjegjshmëri

Ky rast është një apel për një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë dhe në mënyrën se si media trajton çështjet e ndjeshme. Gazetarët dhe ata që merren me informacionin publik duhet të rikthehen tek përgjegjësia për të raportuar të vërtetën, ndërsa gjykatësit duhet të jenë më të guximshëm në marrjen e vendimeve të pavarura dhe objektive. Derisa kjo të ndodhë, qytetarët e zakonshëm, si Natasha R. dhe Armandi, do të vazhdojnë të vuajnë pasojat e një sistemi që shpesh herë vendos më shumë për bazë perceptimin dhe jo fakte të vërtetuara.

Policia, “gjueti shtrigash”, kontrolli kufitar që po shkel liritë qytetare

Sara Demrozi

Një valë masash të reja të vendosura nga Policia e Kufirit dhe Migracionit ka ngritur shqetësime të mëdha në lidhje me kufizimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve. Sipas raportimeve të fundit, të gjitha masat e detyrimit të paraqitjes janë regjistruar në sistemin e policisë kufitare, duke u kthyer automatikisht në një pengesë për individët që përpigjen të udhëtojnë jashtë vendit, pavarësisht se ligjërisht, kjo masë nuk duhet të kufizojë qarkullimin e lirë.

Vendosja e detyrimit të paraqitjes është një masë parandaluese që kërkon nga një individ i dyshuar për përfshirje në aktivitetet të paligjshme të paraqitet periodikisht pranë autoriteteve. Teknikisht, kjo masë nuk ka si qëllim kufizimin e lëvizjes së lirë brenda dhe jashtë vendit, përveçse nëse një vendim i tillë është dhënë nga gjykata përmes një mase specifike të ndalimit të udhëtimit. Megjithatë, praktika e re e policisë kufitare po e trajton çdo masë detyrim paraqitjeje si një arsye për të bllokuar kalimin e kufirit, duke krijuar kështu një situatë absurde dhe të padrejtë për shumë qytetarë.

Një bllokadë që nuk ekziston ligjërisht

Shumë qytetarë janë ndaluar në pikat kufitare dhe u është mohuar e drejta për të udhëtuar, me justifikimin se kanë një masë detyrim paraqitjeje. Problemi është se, sipas ligjit, një masë e tillë nuk kufizon lëvizjen e lirë. E vetmja masë që mund të ndalojë një individ të kalojë kufirin është një urdhër specifik për ndalimin e udhëtimit, i lëshuar nga gjykata pas një procesi të qartë ligjor.

Avokatët dhe ekspertët e të drejtave të njeriut kanë denoncuar këtë praktikë si një shkelje flagrante të të drejtave themelore të qytetarëve dhe një tejkalim të kompetencave nga ana e policisë kufitare. Sipas tyre, kjo politikë është një keqinterpretim i qëllimshëm i ligjit dhe po përdoret si një mjet për të rritur presionin ndaj qytetarëve që ndodhen nën vëzhgim.

Avokati njohur Ndue Pjetra shprehet: “Kjo masë është një abuzim i hapur. Detyrimi për t’u paraqitur nuk përfshin ndalimin e udhëtimit. Ky veprim është tërësisht i paligjshëm dhe i papranueshëm.”

Raste konkrete të padrejtësive

Janë raportuar raste të shumta ku individë që nuk kanë asnjë urdhër ndalimi udhëtimit janë ndaluar në kufi dhe u është refuzuar e drejta për të kaluar jashtë

Sipas raportimeve të fundit, të gjitha masat e detyrimit të paraqitjes janë regjistruar në sistemin e policisë kufitare, duke u kthyer automatikisht në një pengesë për individët që përpigjen të udhëtojnë jashtë vendit, pavarësisht se ligjërisht, kjo masë nuk duhet të kufizojë qarkullimin e lirë

vendit. Në disa raste, ata kanë pasur plane pune, udhëtime familjare apo arsye shëndetësore që janë ndërprerë pa asnjë paralajmërim apo justifikim ligjor.

Një qytetarë e ndaluar në pikën kufitare tregon:

“Kisha një udhëtim pune jashtë vendit dhe kur mbërrita në kufi më thanë që nuk mund të kaloj. Kur kërkova arsyen, më treguan se kam një masë detyrim paraqitjeje, gjë për të cilën nuk më kishin njoftuar më parë. Askush nuk më shpjegoi se përse kjo masë më ndalon të udhëtoj, kur dihet që nuk është një ndalim udhëtimiti.”

Një akt represioni apo keqmenaxhim?

Vendimi për të regjistruar të gjitha masat e detyrimit të paraqitjes në sistemin kufitar dhe për të bllokuar udhëtimet e individëve që janë subjekt i tyre ngre dyshime të forta mbi motivet pas këtij veprimi. Disa ekspertë të drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut argumentojnë se ky veprim mund të jetë një formë represioni nga ana e institucioneve të sigurisë për të mbajtur nën kontroll individët që ata i konsiderojnë të rrezikshëm, edhe nëse

nuk ekzistojnë prova konkrete për të justifikuar një masë të tillë.

Të tjerë e shohin këtë si një pasojë të një keqmenaxhimi burokratik dhe mungesës së qartësisë ligjore në procedurat e zbatimit të masave parandaluese. Në çdo rast, rezultati është i njëjtë: qytetarët përballen me kufizime të padrejta të të drejtave të tyre dhe humbin besimin tek institucionet shtetërore.

Kërkesa për transparencë dhe llogaridhënie

Përballë kësaj situatë, kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie janë shtuar. Organizatat e shoqërisë civile dhe avokatët kërkojnë që:

Të bëhet një rishikim i menjëhershëm i politikave të zbatimit të masave të detyrimit të paraqitjes nga policia kufitare. Qytetarët të njoftohen paraprakisht dhe qartë për çdo masë që mund të ndikojë në të drejtën e tyre për të udhëtuar.

Të vendoset një mekanizëm i qartë dhe i shpejtë për të apeluar dhe shqyrtuar masat e vendosura në mënyrë të padrejtë. Nëse këto kërkesa nuk merren parasysh,

situata mund të përkeqësohet dhe të krijojë një precedent të rrezikshëm, ku të drejtat e qytetarëve mund të kufizohen pa asnjë justifikim ligjor dhe pa asnjë mundësi reale për t’u mbrojtur.

Kur siguria kthehet në pretekst për kufizim të lirisë

Siguria kombëtare është një prioritet për çdo shtet, por nuk mund të përdoret si një justifikim për të kufizuar të drejtat themelore të qytetarëve. Masat e detyrimit të paraqitjes nuk janë, sipas ligjit, të destinuara për të kufizuar lëvizjen e lirë, dhe përdorimi i tyre si një mjet për të bllokuar udhëtimet është një shkelje e hapur e të drejtave të njeriut.

Policia e Kufirit dhe Migracionit duhet të rishikojë menjëherë këtë praktikë dhe të garantojë që të gjitha masat kufizuese të jenë të mbështetura në ligj dhe të komunikohen në mënyrë transparente. Përndryshe, ky veprim nuk do të jetë asgjë më shumë sesa një “gjueti shtrigash” moderne, që do të minojë më tej besimin e qytetarëve ndaj shtetit dhe institucioneve të tij.



Statuti i Drishtit. Si përfundoi në ankand origjinali i këtij dokumenti me rëndësi historike?

Statuti i Drishtit ruhet në Bibliotekën Mbretërore të Danimarkës, në një kuti kartoni ngjyrë jeshile dhe është i lidhur me kopertina kartoni të forta, ngjyrë kafe të errët, ndërsa kurrizi është prej pergamenti të bardhë. Gjashtë faqet e para dhe të fundit janë boshe: janë faqe që iu takojnë kopertinave kur është bërë lidhja e re në fund të shek. XIX. Dorëshkrimi është në pergamen të butë e fin. Kopertina është diçka më e trashë se faqet e tjera. I tërë dorëshkrimi është i shkruar me ngjyrë kafe nga një dorë e vetme. Në këtë dorëshkrim ka dhe një portret të ipeshkvit, Pal Engjëlli me shkopin baritor në dorë, me mitër në kokë dhe i veshur me rroba të kryepeshkvit. Në faqen e fundit të dorëshkrimit është një gjenealogji e familjes së engjëllorëve.

“Statusi i Drishtit”, historiku i dorëshkrimit

Dorëshkrimi i Statutit të Katedrales së Drishtit për herë të parë përmendet në katalogun 438 të antikuarit gjerman, Karl Wilhelm Hiesermann nga Lajpcigu, në qershorin e vitit 1915. Meqënëse dorëshkrimi nuk u shit, Hiesermann i përsërit shënimet e vitit 1915, në katalogun 477 për vitin 1920.

I pari që do tregonte vëmendje për vlerën që përmbante ky dorëshkrim do ishte albanologu kroat, Milan Shuflaj. Ai dëshironte të blente këtë dorëshkrim por nuk kishte mundësi. Ndaj iu drejtua disa bibliotekave të rajonit. Por ndërsa askush nuk po i bindej, ai merr vesh se një blerës anonim e kishte blerë dorëshkrimin për vlerën fenomenale 2.000 marka. Aq ia kishte vënë çmimin antikuarit gjerman. Shuflaj do të ndërhynte nëpërmjet albanologëve të njohur dhe gjen emrin e koleksionistit, për të siguruar një kopje të fotografuar. Kopja u botua dhe ndodhet në Bibliotekën “Arhiva za Arbanasku starinu, jezik i etnologiju. Beograd, 1927”.

Përmbajtja e statutit

Statutet fillojnë me një normë zakonore që përbën një nga traditat më të lashta të popullit shqiptar që është ajo e respektit të ndërsjellë të brezave. Aty thuhet qartë se si rinjtë duhet të respektojnë më të vjetrit dhe shpjegohet mënyra si të vjetrit duhet të duan të rinjtë. Më pas shpjegohet detyra e gjykatësve, si duhet të veprojnë ato dhe ç’dënime japin për për rrahjet, për ankesat e qytetarëve, ndihmën që duhet të jepet ndaj studiuesve etj.

Dorëshkrimi

Dorëshkrimi “Statutet Drishtit” është



një nga më të rrallat ngaqë përmban kapitujt e Katedrales së Drishtit. Ai është i vetmi, statut katedraleje që është zbuluar në qytetet e bregdetit Adriatik, dhe për këtë arsye ka një vlerë të jashtëzakonshme në historinë e Krishtërit. Ai u shkrua nga noteri i Tivarit, Simon Dromasys me 12 janar 1468, i cili bën gjithashtu përshkrimin e variantit të zyrtarizuar të vitit 1464, nga libri i noterit dhe kanonikut të Durrësit, Gjon Mauros, që njëkohësisht ka qenë edhe sekretar i kryepeshkvit të Durrësit, Pal Engjëllit, që ndërkohë kishte vdekur. Variantin e “Statuta et ordinationes capituli eclesiae Cathedralis Drivastensis” nga viti 1464 e kishin punuar kanonikët nga Drishti, të cilët ishin të ditur, të shkolluar, dhe njihnin rrethanat, situatën dhe gjithçka tjetër që kishte të bënte me katedralen dhe me zakonet e Drishtit në të kaluarën. Mendohet se statutet e Drishtit mund të kenë ekzistuar që nga viti 1397.

Pse Europa fillon të hartojë ligje të reja?

Në shekullin X-të Perandoria Kristiane do të tronditej rëndë nga krizat politike. Po shpërbëhej një epokë disa shekulle. Kjo periudhë do të quhet skizma. Pikërisht në këtë kohë kemi mjedise të reja gjeografiko-demografike. Kemi ndarjet e para politiko-administrative dhe u formuan Principatat dhe komunat. Bashkë me zhvillimet e aspektit politik po ndihej nevoja për ndryshim dhe në aspektin fetar. Ndaj lindte nevoja e hartimit të ligjeve të reja politiko-sociale.

Në rrethana të tilla do të lindin misionarët e të drejtës, që do u jepnin zgjidhje nevojave që diktonin terrenet e panjohura.

Forteskie, Gerson, Bartoldo Baldo në Itali, Guljelmi nga Okhami në Britani dhe Marsilio nga Padova qenë misionarët më të mëdhenj që ofruan konceptet e reja dhe kurajoze mbi të drejtat ligjore të “Comunave” dhe “Regnave” – pra të drejtat ligjore të Mbretërive, Qyteteve dhe qytetarëve.

Qenë pikërisht këta misionarë që formuluan parimet se:

“Ashtu si perandori hartonte ligjin universal për të gjithë, ashtu edhe ata që tashmë janë zotër në territore të veçanta, duhet të hartojnë statute ligjore të veçanta për to”.

Kishte lindur kështu mundësia e hartimit të akteve të reja ligjore, nën një koncept të ri rreth “së drejtës”, “sovrانيتit” dhe “vullnetit të sovranit”. Fillojnë të hartohen mbi këtë bazë “Statutet” e para ligjore të Mbretërive, Republikave, Civitates dhe Comunave europiane.

LIGJET E PARA EUROPIANE DHE LIGJET E PARA SHQIPTARE

Pikërisht, në kohët kur fillojnë të hartohen “Statutet” e para ligjore nëpër Europë, në fillimin e shekullit XIV, atë mot fillojnë të hartohen edhe “Statutet” e qyteteve shqiptare të Shkodrës, të Durrësit, Drishtit, etj. Ato “Statute”, në thelb, nuk janë gjë tjetër veçse Kushtetutat e para të tyre.

Por, siç përmendëm, zhvillimet dhe

ndryshimet në Europën e asaj kohe nuk qenë vetëm politike e sociale, ato qenë edhe religjioze. Për rrjedhim, ndryshimet ligjore filluan të ndodhin edhe në këtë fushë.

Gjejnë terren për t’u hartuar “Statute” të tilla edhe në qytetet dhe territoret e Arbërisë, pasi edhe në këto anë të Ballkanit ishte krijuar një infrastrukturë dhe urbanizim i lartë i civilizimit mesjetar, i njëjtë me nivelet e diagramës europiane. Për këto arsye, nuk mund të hartoheshin, aq më pak, nuk mund të zbatoheshin dot Kushtetuta me dispozita që rregullonin dhe administronin shoqëritë e zhvilluara, moderne të kohës, për shoqëri të prapambetura, pa një infrastrukturë të avancuar ekonomike, politike, religjioze, intelektuale dhe qytetare.

Dhe qytetet arbërore i kishin këto nivele, prandaj edhe mund të hartonin Kushtetuta dhe organizonin jetën e tyre mbi shtrate ligjore të barasvlefshëm dhe bashkëkohorë me ata europianë.

Kështu ishte edhe Drishti, një qytet i lulëzuar mesjetar, me një infrastrukturë urbane mjaft të përpunuar, me katedralen e tij dhe institucione të tjera të zhvilluara civile dhe ligjore, me fisnikërinë e tij të njohur qytetare brenda dhe jashtë Arbërisë, me magistratët dhe noterët, me komunitetin e tregtarëve të shumtë, me fuqinë ekonomike mjaft potenciale, gjer aty sa priten edhe monedha të bronzta, me muret rrethues hijerëndë, me intelektualë të shquar që mund të krijonin dhe hartonin ligje të denjë për të qenë rivalë me fqinjët e tyre perëndimorë.

Lidhur me Kushtetutën e Shtetit të Parë Shqiptar, Principatën e Arbërit, i quajtur Kanuni i Skënderbeut



**Ish-Prokuror
Shkëlqim Kokona**

“E drejta për një proces të rregullt”, përcakton shprehimisht se: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat / detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”

Teza e parë: Vetitë shtetformuese të shqiptarëve, historiku i shtetit të parë shqiptar e quajtur Principata e Arbërit e ngjashme me atë të Savojës në Itali dhe Kanuni i Skënderbeut si Kushtetuta e shtetit të parë shqiptar. Pak fjalë për historikun e mbledhjes dhe botimit të kësaj vepre madhore për historinë e Shqipërisë dhe autorin e saj, At Frano Ilija. Vlerat e saj historike dhe ato aktuale e Kushtetutës së shtetit të parë shqiptar dhe qëndrimi antikombëtar i diktaturës, që autorin e saj e dënoi me vdekje me një proces të montuar gjyqësor. Qëndrimi i lënies në harresë të kësaj vepre madhore në ditët tona si vazhdimësi e qëndrimit antikombëtar të institucioneve të shtetit të sotëm.

Teza e dytë: Kanuni i Skënderbeut, vlerësimi i teknikës legislative të përdorur nga autori në mbledhjen, botimin e saj si dokument bazë i shtetit të parë shqiptar. Vlerat e katalogimit dhe parimet bazë të ndërtimit të shtetit të Skënderbeut si familja legjitime natyrore e mbretërisë së parë shqiptare. Fatkeqësia e mungesës së provave dokumentare autoktone të këtij kanuni dhe përdorimi i trashëgimisë dhe përvojës gojore të këtyre zonave dhe territoreve, të cilat kanë përbërë territoret e Principatës së Arbërit. Kanë kaluar më shumë se njëzet e pesë vjet nga botimi i këtij dokumenti monumental dhe është lënë në harresë duke i lënë shteg propagandës së armiqve të shtetit shqiptar për mungesën e historisë shtetndërtuese tek shqiptarët, duke i paraqitur ata si popull barbar dhe jo të civilizuar. E vërteta historike e familjes mbretërore të Skënderbeut dhe figurës së tij, që duhet të barazohet me familjen e Savojës në historinë shtetformuese italiane dhe studimi i saj dhe kanunit të kësaj mbretërie del e domosdoshme në mijëvjeçarin që jetojmë, ku faktori shqiptar është bërë për herë të parë i rëndësishëm gjeopolitikisht për historinë e Ballkanit dhe të Evropës.



Teza e tretë: Periudha historike dhe territoret në të cilat u formua dhe ekzistoi Principata e Arbërit, konteksti historik dhe gjeopolitik i formimit të embrionit të shtetit të parë të shqiptarëve si rezultat i ndarjes së kishës katolike në atë të perëndimit dhe lindjes dhe lidhjes së shtetit të parë shqiptar me Papatin e Romës dhe shkëputjes nga Perandoria Bizantine, lindjes. Sot ky problem gjeopolitik është ak-

tual, ku shqiptarët janë në përpjekjet e tyre të para në histori për krijimin e Shqipërisë natyrore dhe shkëputjes nga influencat e lindjes, Rusia dhe Kina dhe bashkimin me Bashkimin Evropian.

Teza e katërt: Ndërtimi i shtetit të parë të shqiptarëve. Forma e regjimit të tij: mbretëria, principata. Organizimi shtetëror administrativ me tre pushtetet: atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Përqendrimi i tre pushteteve në një dorë të vetme, atë të princit ose familjes së Gjonmarkajve.

Teza e pestë: Organizimi shtetëror administrativ dhe konkretisht pushteti legjislativ, ku përfshihen kuvendet e pleqve, të cilat miratonin normat zakonore dhe të drejtën që kishte familja princërore e Gjonmarkajve për interpretimin e Kanunit të Skënderbeut si Kushtetutë e Principatës ose shtetit.



Teza e gjashtë: Organizimi shtetëror dhe konkretisht pushteti ekzekutiv që përfaqësohej nga bajraktarët ose flamurm-bajtësit dhe që kryesohej nga familja princërore e Gjonmarkajve.

Teza e shtatë: Organizimi shtetëror dhe konkretisht pushteti gjyqësor. Si kryegjyqtar njihej princi ose bajraktari i familjes së Gjonmarkajve dhe si organe gjyqësore në bazë njiheshin kuvendet e pleqve ose pleqtë të organizuar në këshilla. Njihej dhe figura e këpucarit që përfaqësoje subjektin që bënte hetimet dhe ngrinte akuzë ndaj shkeljes së normave kanunore dhe që kryenin krime dhe delikte.

Teza e tetë: Organizimi shoqëror i Principatës. Njësia më e lartë e organizimit shoqëror është fisi, katundi, bajraku, shtëpia dhe më e ulta vogëlia. Kombi shqiptar formohej prej fiseve, të cilat luanin rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Elita politike dhe kulturore vendit përcaktohej nga fiset më të dëguara dhe më të pasura. Familja kryesore ishte ajo e princit, konkretisht e Skënderbeut dhe më vonë bajraku ose fisi i Gjonmarkajve që ka lënë gjurmë akoma në ditët tona në këto zona.

Teza e nëntë: Organizimi i besimit, religjionit dhe zbatimi i parimit të sekularizmit, ndarjes së fesë nga shteti dhe shoqëria civile që në atë kohë gjatë Principatës së parë, atë të Arbërit dhe Kushtetutës, Kanunit të Skënderbeut. Principata dhe Kanuni i Skënderbeut njih dy fe zyrtare, atë të katolicizmit dhe atë të myslimanizmit. Që në atë kohë dy fetë kryesore bashkëjetojnë në harmoni me njëra-tjetrën.

Teza e dhjetë: Normat e të drejtës civile dhe familjare në Kanunin e Skënderbeut. Këtu kemi të bëjmë me institute të rëndësishme si fejesa, martesja, kunora fetare katolike, kunora fetare myslimane, të drejtat dhe detyrimet e burrit dhe gruas në martesë, statusi i fëmijës, fëmija pa kunorë, trashëgimia, shtëpia, pasuria e shtëpisë, ndarja e shtëpisë dhe pjesëtimi i pasurisë së shtëpisë.

Gjoja ose gjyeta, Huaja ose kontrata e huasë, Haxheti ose kontrata e porosisë ose dhënies

në përdorim,

Vadja ose parashkrimi, E folmja ose Kontratata, E falmja ose kontrata e dhurimit.

Teza e njëmbëdhjetë: Normat e të drejtës administrative në Kanunin e Skënderbeut. Qeverisja, Bajraku dhe organet e tij, Bajraktari, Pleqtë në përgjithësi, Pleqtë e bajrakut, pleqtë e katundeve, pleqtë e fiseve, strapleqtë e fiseve, pleqtë e thjeshtë, pleqtë e çështjeve të veçanta, pleqtë e pengjeve.

Vogëlia, Gruaja, Lajmëtarët, Kasnecët, Fjalëtorët, Kuvendi.

Teza e dymbëdhjetë: E drejta kontraktore e punës sipas Kanunit të Skënderbeut. Punëtorja. Kontrata e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Bariu. Kushtet e punës, etj. Bariu i paguar.

Shemriakët. Marrëveshja e disa shtëpive për të kullotur bagëtinë së bashku.

Rrogatari ose punëtor i me mëditje, një formë e bujkrobërisë.

Udhëtar i paguar. Personi që dërgon një porosi ose mall me porosi të pronarit.

Punëtorët. Upr i grup me disa punëtorë.

Dy forma pune falas, zakonisht ose me hua, rrallë.

Tre forma shpërblimi me pagesë, huanike dhe falanike.

Punëtorëve huanike dhe falanike u jepet ushqimi (dreka), etj., ndërsa ata me pagesë sipas zakonit të shtëpisë së punëdhënësit.

Bulku. Kushtet e dhënies dhe marrjes së tokës për ta punuar.

Mullisi. Kushtet e dhënies dhe marrjes së mullirit për ta përdorur.

Ujemi. Shpërblimi që merr mullisi për bluarjen e mallit.

Farkëtar i. Kushtet dhe pozita e farkëtarit në lidhje me katundin dhe ushtrimin e zanatit.

Tregtari. Kushtet dhe veprimtaria e tregtarit sipas rregullave të katundit.

Përbujorja ose Hoteli. Kushtet dhe rregullat e menaxhimit të tij.

Lundra apo trapi. Rregullat e menaxhimit të tyre.

Teza e trembëdhjetë: Dorexania. Rregullat dhe kushtet e këtij instituti të procedurës civile.

Teza e katëmbëdhjetë: Parashikimet e Kanunit të Skënderbeut lidhur me ndëshkimet penale. Cili institucion i jep dhe llojet e ndëshkimeve.

Gjoha. Kuptimi dhe llojet e saj dhe cili institucion i jep dhe i zbaton.

Lecitja. Kuptimi dhe cili institucion e jep dhe e zbaton.

Qitja jashtë vendit. Kuptimi dhe cili institucion e jep dhe e zbaton.

Dhanja e fishekut. Është i barabartë me dënimin me vdekje. Cili institucion e jep dhe cili e zbaton.

Zjarmi dhe premja e pemëve. Kuptimi dhe cili institucion e jep dhe e zbaton.

Grimja e fajtorit. Do të thotë ekzekutimi i dënimit me vdekje. Cili institucion e jep dhe cili e zbaton.

Ndëshkimet e caktuara prej kanunit. Llojet e ndëshkimeve dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

Llojet e ndëshkimeve. Digjet. Shembet gur dhe themel.

Grihet katundisht. Gjobitet.

Robt e shtëpisë së tij qiten jashtë bajrakut për kohën 3 deri 15 vjet apo përgjithmonë.

Rastet kur jepen. Kush vret gjaksin pas gjakut në falun.

Kush vret gjaksin në kuvend të dhanun dhe në beset e vet.

Kush vret gjaksin si ti këtë hy mbrendë.

Kush shpifet në punë të rëndë.

Kush vret meshtarin.

Kush vret fisin e gjaksit jashtë 24 orëve të kryerjes së vrasjes.

Kush vret Vra e hup. Nuk i con fjalë brenda tridhjetë ditëve se vrasjen e ka ba ai.

Kush vret vëllain, kushërinin dhe kend të afërt të vëllait ose fisit për ti marrë tokën.

ETC. Zbatuesit e ndëshkimeve të kanunit.

Gjohetarët. Pleqnija ose Gjyqi. Norma procedurale gjyqësore.

Pengu. Opengat e pleqve.

Mohi. Parimi i prezumimit të pafajësisë. Teza e katëmbëdhjetë. Temifi ose Padija.

Teza e pesëmbëdhjetë. Beja.

Kushtet e besë.

Beja pa parote.

Beja me parote.

Beja për të vdekun.

Parota.

Veprimi i parotës.

Teza e gjashtëmbëdhjetë. Kepucari.

Shqyrtuesit e kepcuarit.

Beja e rrejshme.

Teza e shtatëmbëdhjetë. Fajet dhe dëmet.

Dëm dhe faj kundër jetës.

Vrasa.

Plaga.

Prita.

Dy prita afër njëres tjetres.

E shkelmja.

Deshtimi.

Teza e tetëmbëdhjetë. Shtëpia në gjak.

Pagesa, buka e shtymja për vrasë.

E drejta e marrjes së gjakut.

Lidhja për gjak.

Gjaku shkon për gisht.

Gisht e havale. Parimi i marrjes së gjakut

vetëm ndaj gjaksit.

Gjaku mbas tokës. Kokë a tokë.

Gjaku i të mirit a të keqit njësor.

Gjaku nuk ngel për faj.

Gjaku s'bahet gjobë.

Vrasa prej gjësë së gjallë.

Vrasa pa hiri.

Vrasa me rob të shtëpisë.

Vetvrasa.

Kuvendi për gjak.

Dorxanet e kuvendit.

Pajtimi i gjakut.

Dorxanet e gjakut të pajtuem.

Cmimi i gjakut të falun dhe Dorxanet.

Kush i merr të hollat e gjakut.

Buka e gjakut dhe kryqi në derë të Doranit.

Teza e nëntëmbëdhjetë. Dëmet kundër pasurisë.

Dëmi i bërë prej njeriut.

Fjala me ngatërresë. Krimet verbale.

Hjeksia.

Vjedhja.

Mashtrimi.

Grahitja.

Preja.

E drejta e të zotit të mallit.

Teza e njëzetë. Dëmi i bërë prej gjësë së gjallë.

Thiu në dëm.

Damtoi gjaja gjanë.

Qeni në dëm.

Kurtha e laku.

Lidhja për vjedhje, dëm, e ngatërresa.

Teza e njëzetë e një. Dëmi e faj kundër Nderit.

Bese, nderë, burrni.

Fajet kundër nderit.

Arma e marrë me dhunë.

Preka e gruas.

Rrahja.

E shamja.

Shpifja.

Teza njëzet e dy. Kisha.

Kisha në vetvete.

Kisha është e paprekshme.

Nderi i kishës.

Vorret.

Pronat dhe pasuritë e kishës janë të paprekshme.

Rregullimi i pasurisë së kishës.

Ipeshkvi.

Famullitari.

Të drejtat dhe detyrat e famullitarit.

Pleqtë e kishës.

Rrogëtar i kishës.

Punëtor i kishës.

Ndëshkimet kundër fajtorëve të kishës.

“Shqipëria një histori e mentaliteti juridik”, e drejta jonë shekullore e të jetuarit fisnikërisht në drejtësi



Nga Albert Vataj

Kësisoj ne jem gatue e kësiudhësh e kemi patur shtegun për të ardhur derimkëtu, dhe është hyjnore të ngresh zërin dhe grushtin, të brofësh në këmbë e të tendosesh në sëmbim, të tregosh me zë e me zemër se ka një akt fisnik që e ka shteguar rrugëtimin në rrëmet e në turbullim dhe ai është shpirti i të drejtës blatur në vetë shenjtërinë e drejtësisë. Në ka një komb që ka vlerësuar si parësore të drejtën, ai të hyjshme këtë sublime, ai është populli shqiptar, të cilit në ndërkohje prej krejtçkasë, atij i interesoi ligjësia, t’jetuemit në të drejtë, pa i hy në hak as Zotit as robit. Aq ishte ky postulat sa u bë histori besimi, u shndërrua në atë që besonin dhe gatiteshin t’i blatoheshin kësaj lartësie sublime si një procesioni të shenjtë.

- E ekzagjeruar kjo?

- Jo aspak!

Ishte vetë jeta jonë, ishte ajo që u gatua dhe u desh kohje të pranohej, duke u ndeshur gjithqysh kundërshtishë e keqdashirimesh trajtuese. Kësodoresh vjen në një ngutje për çfarë tregon vetë Valentini, njëri nga studiesit më të thellë dhe më kontribues në fushën e e së drejtës tonë kanunore, sipas të cilit: “Shqiptarët - shkruan ai janë një popull i çuditshëm. Të huajve u duket se kanë një tërësi ligjesh e parimesh që kundërshtojnë njëra-tjetrën, konflikte të pashërueshme, grindje të brendëshme ku ndryshimet fetare, rajonale dhe kulturore, nxisin impulse të papërmbajtshme shkatërruese, mirëpo pas kësaj, kur bëhen gati të shprehin një gjykim negativ mbi mundësitë e mbijetesës kombëtare, vërejnë se si shpërthen

papritmas prej thellësive të shpirtit të tij një ndjenjë e fortë vëllazërimi që të shtang e të magjeps....

Një libër nuk mund ti thotë të gjitha, as “Shqipëria një histori e mentaliteti juridik” i Ndriçim Kullës nuk merr përsipër ta bëjë këtë, por ai rreket të qartësojë në një masë të konsiderueshme, se cila ishte marrëdhënia e shqiptarëve me të drejtën. Pavarësisht folklorizmave e retorikës bisedore, tjetërsimeve dhe ekzagjerimeve, keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve, bartjeve të copëzuara prej një kujtese joefikase, prirjeve për t’i shndërruar në legjenda dhe neglizhencave për të mos i marrë në konsideratë, injorancës dhe manipulimit prej rrufjanëve keqdashës, e drejta shqiptare për të drejtë është vetë tharmi me të cilën ky iden-

Libri studimor i Ndriçim Kullës, “Shqipëria një histori e mentaliteti juridik” është një qasje jo dhe aq për të nga grishur në një joshje leximi, sa ç’është një thirrje e krahoheshme që kemi dëgjuar, amanet i kahmotshëm që kemi premtuar, është vetë origjina jonë, e cila, na ysht në një gjendje detyruese për të dëshmuar me interes dhe konsideratë, atë që është e themeltë e ekzistencës sonë, atë që është vetë sublimja e shpirtit të qëndrësës ballë rrëmeteve dhe ekspansioneve, fatkobeve dhe zezonave që na ndërseu koha, të cilave i bëmë ballë. Dhe kjo nuk ishte më pak se çdo kacafytje e gjakësim tjetër që na përfshiu në një ngulm mbijetese, në atë që ishte për ne betim e besë.

Siç shkruante At Gjergj Fishta në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit, kundërshtarët e kombit shqiptar dhe shumë “pedanta vendas e muhaxhirë të shtetit shqiptar”, Kanunin e mbajnë si ligj barbar dhe popullsinë ku Kanuni kishte vlerë juridike, për njerëz të egër. Theksimi i hakmarrjes për të treguar barbarinë e një kombi nuk qëndron dhe nuk tregon egërsinë e shpirtit të një populli. “Të marrunit e gjakut buron prej mndorjevet të jashtme e prej të metave t’organizimit shoqruer të një kombi, e jo gjithmonë prej gjejes shpirtnore të tij”.





titet u ngjiz.

Edhe pse turavrap për të ikur ose për të mos i marrë në konsideratë, la si një damkë më shumë se si një ligjësi, Kanunin e Lekë Dukagjinit, e vërteta e mbështetur në fakte, realja e sendërtuar përmes një dashamirësie që fatmirësisht pati idhujtarë të devotshëm, bëri të mundur që të argumentojë se rrugëtimi shqiptarëve në histori ishte i mbështetur mbi baza të forta juridike. Më shumë se shkenca e së drejtës, identitetin tonë fisnik e udhëpriu instinkti i të drejtës, ligji i besimit të drejtësisë. Sepse ne e kishim në gjak drejtësinë, siç patëm besën dhe guximin për t'u ndeshur me zemër e me shpirt për diçka që në ne ishte besim i pikuar nga lart. Për një dritëpërshkueshmëri në thellësinë më të errata të njohjes, studiuesi dhe publicisti, Ndrichim Kulla sjell, "Shqipëria një histori e mentaliteti juridik". Kësisoj ai sjell një tjetër monument të përkatësisimit tonë identitare. Një tjetër kreshtë e vetëdijësisimit të vlerave dhe traditave sonë, lartëson në eterin e asaj me të cilën përfaqësohemi. Të shkruante një biografi për mentalitetin juridik shqiptar nuk është se ka qenë një ëndërr në sirtar e Ndrichim Kullës. As që e shkonte ndërmend 20 - 30 vite më parë, madje as me fantazinë e tij nuk kishte shkuar pranë një projekt i tillë të cilin ta kishte ushqyer në heshtje. U deshën kohje, që përmes leximeve dhe botimeve të tij, punës së vullnetshme kërkimore dhe shkencore, si autor librash dhe botues, të kalonte nëpër duar veprat e mendimtarëve shqiptarë sidomos ata të ndaluar, të zbardhte veprën dhjetëra vëllimshme të albanologut italian me fame botërore At Giuseppe Zef Valentini, që më në fund të merrte ngacmimin e duhur për të shkruar një libër të tillë që i vlen shumë kulturës dhe studimeve shqiptare.

Duke vlerësuar si të rëndësishme prioritarë qartësimin e asaj që bart në vetvete ky kulmim komunikimi dhe iluminizmi, sjell çfarë vetë Ndrichim Kulla mendon, çfarë ai kumton kësisoj në këtë qasje për të kërkuar interesim dhe vëmendje. Sipas tij, "Ky libër më tepër vjen si një zgjatim në raport me

tërë punën që unë kam bërë, si studiues dhe hulumtues i literaturës së mendimit shqiptar, sidomos atij mendimi që ka qenë kryesisht i ndaluar nga sistemi komunist për arsye politike."

Për Ndrichim Kullën "Shqipëria një histori e mentaliteti juridik", është nga librat më vitegjatë që puna hulumtuese dhe leximet e shumta e kanë mbushur me informacion, por gjithashtu edhe me një yshtje për ta konsideruar dhe trajtuar si të një vlere prioritare ofrimin për lexuesin dhe kryesisht hulumtuesve, këtë kontakt, këtë tërësi informacioni, i cili rreket të sqarojë shumë gjëra, të saktësojë shumë pamjaftueshmëri, të ballafaqojë faktet dhe të dhënat, si dhe të sjell gjithë traditën tonë të kohëpaskohëshme për të drejtë, në një libër. Autori e ka konsideruar dhe vlerësuar këtë veprë si më të rëndësishmen e krejt kolanës së tij dhe kjo për arsyen e vetme se ky nuk është një libër, është vetë historia mentalitetit juridik shqiptar, mënyra se si ata bënë drejtësi edhe kur u mungonte gjithçka, por jo e drejta për të bashkëjetuar me drejtësi, si shprehje e një shpirti civilizues

"Për dekada me radhë gjatë leximeve dhe studimeve të mia me objekt shpesh edhe të pa përcaktuar jam "detyruar" që me dashje ose dashje të prekja gjurmët e mentalitetit juridik shqiptar. Që nga thellësia e shekujve, madje edhe deri para kohëve mesjetare kur nuk



kishte kurrfarë informacioni edhe për Evropën e cila sapo kishte filluar të zgjohej ngadalë-ngadalë vijnë gjurmët e qarta të këtij mentaliteti. Përtej krrrau-krraut të sorrave që nxijnë dhe fshijnë gjithçka ku, në biseda të ndryshme madje edhe në debatet publike, se ne qenkesh se jemi një popull pa trashëgimi qeverisëse dhe juridike dhe se kemi jetuar gjithmonë pa ligje dhe pa rregulla më rikthenin thirrje zgjimi dhe me argumenta të kundërta të këtij trishtimi të krijuar ,se ne jemi popull me koncept të qartë juridik." aartëson Kulla.

Duke vijuar se, "pushtimet e huaja të herë pas herë kanë lënë pasojet e tyre shkatërruese në prishjen e rendit juridik, që kishte vendosur populli ynë për tu vetë administruar dhe bashkëjetuar.

Besa, fjala e dhënë, kodi juridik zakonor, kanunet, që nga ai i Lekë Dukagjinit, deri tek ai i Idriz Sullit, statutet, që nga ai i Drishtit deri tek ato të Shkodrës, korporatat dhe marrëveshjet e Esnafëve, kodikët e shumtë të disa qyteteve, kuvëndet i pleqësisë etj., janë dëshmi të forta mëtuese, se si paraardhësit tanë kanë rregulluar marrëdhëniet e jetës dhe të paqes sociale në jetesën e tyre. Është pikërisht kjo forcë e karakterit, kjo thelbësore e gjenezës fisnike, kjo tërësi e asaj që përcaktoi rolin tonë në histori, që specifikoi vendon e merituar në atë të drejtë, e cila ishte prioriteti i bashkëjetesës, e cila mund dhe ishte e ekspozuar përballë shumë privacioneve, por nuk toleronte padrejtësinë dhe çdo përllojë e asaj që ata kosnideronin si të drejtë, si legjitime.

Libri studimor, hulumtues, ballafaques, argumentues, "Shqipëria një histori e mentaliteti juridik" i Ndrichim Kullës vjen për të mbushur një hendet të thellë dhe për të dëshmuar përmes argumenteve dhe fakteve se ne jemi një popull, i cili të drejtën ka patur ndër parshmëritë më të parshmin gëgjje të aftësisë për të bashkëjetuar dhe fisnikërimin të aktit drejtësi, njëjt për të gjithë, si në një gjykim sublim para vetë Zotit.



Kodi i Lek Dukagjinit, më i vjetri në Evropë


Pas Skënderbeut, personaliteti më i spikatur i kohës së tij ishte Lekë Dukagjini. Për 25 vjet Skënderbeu e mbrojti fuqishëm Shqipërinë kundër sulmeve të furishme të turqve, dhe kontributi i tij ushtarak nuk do të harrohet. Bëmat e tij janë të përmbledhura në thënien angleze: “shpata e Skënderbeut k rkon krahun e Skënderbeut “Edhe pse Leka ishte gjithashtu një luftëtar i shkallës së parë dhe luftuan me Skënderbeun për të sprapsur pushtuesit, ai mbahet mend më shumë si pionier i nxjerrjes së ligjeve. Ishte ai që kodifikoi ligjin tradicional të pashkruar të Shqipërisë së Veriut, që besohet nga shumë autoritete të jetë ligji ekzistues më i vjetër në Evropë. Kanuni i Lekë Dukagjinit, ose Kodi i Lekë Dukagjinit qeverisi malësitë për afër 500 vjet, edhe pse ai nuk ekzistonte në formë të shkruar deri në vitin 1933. Kjo vërtetë është një vlerësim i lartë për personalitetin e Lekës.

Kodi i Hammurabit

Është historikisht e saktë të thuhet se me zhvillimin e njerëzimit u zhvillua nevoja për ligjet dhe rendin. Në shoqëritë primitive, megjithatë, ligji duhej të trashëgohej nga tradita gojore, dhe drejtësia përsosej sipas zakoneve fisnore. Shumica e krimeve dhe ankesave zgjidheshin nga vetë njerëzit, dhe gjakmarrjet midis familjeve ishin në rend të ditës. Me përparimin e qytetërimit vënia e drejtësisë u mor nga duart e individëve dhe ligjet u kodifikuan dhe u përcaktuan me shkrim. Ligji më i vjetër i shkruar në ekzistencë është Kodi i Hammurabit, i formuluar nën mbretin e famshëm të Babilonisë me atë emër i cili ka jetuar rreth 2100 para Krishtit.

Disa Ligjvënës të famshëm

Në vitin 621 para Krishtit, ligji gojor i Athinës u kodifikua nga një fisnik me emrin Drako, i cili e hoqi interpretimin e tij nga duart e aristokratëve. Për më tepër, ai vuri kompetencat për krimin nën shtetin, në vend të duarve të një fisi apo familjeje. Megjithatë, ligjet e tij, nuk ishin shumë popullore sepse ishin shumë të ashpra, dhe një kritik mendohet të ketë thënë se kodi është shkruar jo me bojë, por në gjak. Një tjetër athinas, Soloni (640-559 para Krishtit) i njohur si një nga “Shtatë të Urtët e Antikitit”, u porosit që të rishikojë ligjet dhe shpalli të famshmen



Kushtetutë Soloniane.

Ligji romak mbeti i pashkruar deri në vitin 449 para Krishtit kur u miratua Ligji i Dymbëdhjetë Tabelave. Megjithatë, një nga emrat më të famshëm në historinë e jurisprudencës është perandori Justinian, shqiptar “i pagdhundur”, i cili nga 527-565 drejtoi Perandorinë Lindore. Në Justinianin u bë mbledhja më e plotë e ligjeve romake nën emrin Corpus Juris Civilis, duke ruajtur k shtu thesaret e jurisprudencës së lashtë. Për më tepër, Corpus Juris Civilis është edhe baza kryesore e ligjeve moderne civile në botën perëndimore.

Grindje midis Lekës dhe Skënderbeut Historia e Skënderbeut është vënë në dispozicion të lexuesit në anglisht përmes studimit të thellë të Kryepeshkopit Noli, “George Castrioti Scanderbeg”. Biografia e Lekë Dukagjinit ende

mbetet për t’u shkruar, sepse deri tani fama e tij ka qenë e kufizuar kryesisht në malësitë shqiptare. Megjithatë këto janë disa fakte të njohura interesante në lidhje me këtë njeri dinamik. Para së gjithash familja e tij, Dukagjini apo Duka Gjini, ishin paria më e fuqishme e Shqipërisë së Veriut. Edhe pse Leka dhe Skënderbeu ishin fqinj, të dy burrat nuk ishin tamam miq. Për një kohë, një grindje ekzistoi mes tyre, dhe shumë kishin frikë se armiqësia në mes të dy burrave mund të çonte në luftë civile. Pajtimi mes tyre u realizua nga Peshkopi i Drishtit me urdhër të Papës në fuqi.

Siç është e regjistruar nga Kryepeshkopi Noli, Leka morri pjesë në rrethimin e Krujës, në të cilën turqit u thyen, dhe ishte këshilla e tij, dhe jo e Skënderbeut, që mbizotëroi në mesin e parisë që të mos lejonin ushtarët e

dorëzuar turq të largoheshin për në atdheun e tyre të paarmatosur. Megjithatë, kur Skënderbeu vdiq ishte Leka që thirri nekrologjinë, “njoftim për të katër erërat vajtime shurdhuese dhe zemër-thyerëse në mënyrë që e gjithë Shqipëria të mund ta dëgjonte lajmin.”

Leka shpall ligjet

Pushteti i Lekës, thuhet, zgjaste deri në jug në qytetin e Lezhës, e cila u bë kryeqytet i tij. Atje ai mbledhi krerët e maleve në parlament që të formulonte ligjet e tij. Edhe vetë Skënderbeu personalisht, ishte në mesin e deputetëve të cilët peshonin argumentat e çështjeve të ndryshme të paraqitura nga Leka. Thuhet se njëherë të dy liderët, në fillim nuk u pajtuan dhe më vonë ranë dakord në parimin se të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit. Kështu paraqitet një legjendë në librin e Margaret Hasluck “Ligji i pashkruar në Shqipëri.” Në një rast Lek Dukagjini kishte ardhur me ftesën e Skënderbeut për të diskutuar në Asambleenë e Përgjithshme të të gjitha fiseve të vendit mbi disa gjakmarrje. Skënderbeu kundërshtonte parimin “një jetë për një jetë” me arsyetimin se jo të gjithë njerëzit janë të barabartë; gjaku i një njeriu fizikisht te aftë ishte i ndryshëm nga ai i një të dobëti. Megjithatë, me sugjerim e Lekës, ai pyeti nënën e tij, në besë, se çfarë lloj njeriu kishte qenë babai i tij. Kur mësoi se ai kishte qenë i dobët, Skënderbeu në Kuvendin e ardhshëm ra dakord për parimin e barazisë”.

Kodi i qëndroi kohës

Pas disfatës së Shqipërisë, turqit nuk mundën t’i nënshtrojnë njerëzit e malësisë. Ndërsa pjesa tjetër e Shqipërisë qeverisej, pak a shumë, në përputhje me ligjet e Perandorisë turke, veriu i Shqipërisë për afër pesë shekuj ka qenë i qeverisur nga Kodi i Lekë Dukagjinit, të cilin malësorët e mbajnë aq të shenjtë sa Shkrimin e Shenjtë. Ligjet e Lekës kanë qene ne fuqi imtësisht në të gjitha fazat e jetës në malësi, duke përfshirë edhe gjakmarrjen dhe martesat. Në to, gjithashtu, bëhet thirrje vetëm për dy dënime: gjobën dhe djegien e shtëpisë së fajtorit. Dënimi me vdekje ishte i panjohur. Edhe pse primitive, ligjet ishin të bazuara në idealet e nderit dhe të vdekjes heroike, dhe në lidhje me këtë, është interesante të theksohet se shumica e këngëve popullore



shqiptare kanë origjinën në veri të Shqipërisë. Sipas studiuesve, mjedisi kulturor në të cilin ligjet u zhvilluan është i ngjashëm me atë të përshkruar në poemat homerike dhe sagat islandeze. Tipar negativ në lidhje me Kodin e Lekë Dukagjinit, megjithatë, është fakti se ai mbajti popullin e malësive në një gjendje të thellë të injorancës, aq të rëndë sa një antropolog i njohur ka deklaruar se “gjuha dhe zakonet i kanë kthyer ata në epokën e hekurit”. Nën Zogun, u bënë përpjekje për t'i zhdukur ligjet, dhe nuk ka nevojë të thuhet, ato nuk janë toleruar aspak nga regjimi komunist në fuqi.

Me interes për studiuesit

Historikisht Kodi i Lekë Dukagjinit është me interes të madh për studiuesit. Në vitin 1913, studiuesi Françeskan Shqiptar, Shtjefen K. Gjeçovi mblodhi nenet e kodit, të cilat u botuan pas vdekjes së tij në 1933, si “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Faik Konica ishte një nga shqiptarët e shquar i cili shkroi një hyrje të librit. Për një përshkrim të Shqipërisë së Veriut janë dy libra të admirueshëm shkruar nga Edith Durham – “High Albania” (1909) dhe “Disa Prejardhje, Ligje dhe Zakone Fisnore të Ballkanit” (1928). Të dyja këto vepra japin një informacion të shumtë mbi Kodin e Lekë Dukagjinit. Libri i fundit që ka dalë në këtë temë është ai i Margaret Hasluck, “Ligji i pashkruar në Shqipëri”, botuar pas vdekjes në 1954. Në diskutimin për rëndësinë historike të Kodit të Lekë Dukagjinit, J.H. Hutton, një antropolog britanik dhe redaktori i librit, bën deklaratën e mëposhtme: “Por ligjet zakonore shqiptare janë me interes

të veçantë për atë që ne tani i kemi të shënuara me detaje kur ndodhi kalimi në nga faza thjesht zakonore me atë të ligjit të miratuar dhe të shkruar.” “Ndoshta, disa nga këto fakte mund të çojnë ndonjë student të Shqipërisë për të bërë kërkime të mëtejshme në një fazë kaq të rëndësishme të kulturës shqiptare.

thotë Abdurrahman Amhah. Herën e parë ka ardhur në vitin 2016 përmes Detit Mesdhe në Itali. Në pikun e krizës së migrantëve ai mbërriti deri në Gjermani. Por kërkesa për azil në Gjermani iu refuzua dhe e dëbuan, shpjegon marokani. Më pas ai u nis sërish për në Evropë - kësaj here përmes rrugëve të rrezikshme nëpër Ballkan. “Udhëtova me avion për në Turqi dhe nga Turqia shkova në Bosnje. Të gjithë rrugën e kam kaluar më këmbë - pjesërisht duke ecur, e disa pjesë kam udhëtuar edhe me makina. Ishte e vështirë, sepse në Greqi ka pasur edhe borë. Këmbët m'u bënë me plagë gjatë rrugës.” - tregon Abdurrahmani.

Fëmijë me një kosovare

Ai tani sërish synon Gjermaninë. Na thotë se atje ka një fëmijë me një kosovare, e cila është e regjistruar në Torgau. Por meqenëse ata nuk kanë pasur celebrim, ai nuk mund të dëshmojë që është babai i fëmijës dhe të vijë legalisht në Gjermani. “Unë nuk e kam parë ende fëmijën tim, nuk e kam marrë kurrë në dorë. Kjo është e vështirë për mua, sepse jam babai i tij.”

Shpresë se një ditë do të mbërrijnë në Gjermani, Spanjë apo Francë

Ndaj Abdurrahmani po përpiket – ashtu si edhe shumë të tjerë në kampin në

Velika Kladushë - që të kalojë përsëri ilegalisht kufirin kroat. Ilegalisht, sepse ai nuk ka asnjë dokument. Pasaportën e ka lënë qëllimisht në Turqi, pas ardhjes atje me avion nga Maroku. Ai druante, se Greqia do ta kthejë menjëherë, pasi Maroku në Greqi konsiderohet vend i sigurt i origjine.

“Nuk është ilegale të lëvizësh”

Fate të njëjta kanë përjetuar edhe shumë të rinj në kampin „Miral”, i cili është vetëm pak kilometra nga kufiri i jashtëm i BE-së. Por shumica e migrantëve këtu janë nga Pakistani. Si 31 - vjeçari Zulqar Nain. Ai ka kaluar nga vendlindja nga frika prej islamistëve. Vendi i preferuar i tij - është Spanja. Edhe ai ka tentuar disa herë ta kalojë ilegalisht kufirin me Kroacinë. “Unë këtu nuk jam i legalizuar dhe kalimi ilegalisht i kufirit nuk është mirë. E di këtë. Ndaj nuk është problem nëse më kapin dhe më dëbojnë. Po nuk duhet të më prekin, të më denojnë apo të m'i thyejnë këmbët. E di që nuk kam të drejtë. Por nuk është ilegale të lëvizësh, ilegale është vetëm të kalosh kufirin.” - thotë Zulqari.

Kampi Miral

Policia kufitare kroate i ka hedhur poshtë të gjitha akuzat e migrantëve për ushtrim dhune ndaj tyre. Ndërsa policia lokale në Bihaq pohon se migrantët të kthyer nga Kroacia i kanë gjetur në gjendje shumë të rëndë. “Ka pasur raste kur migrantët janë keqtrajtuar nga policia kufitare e Bosnjes apo Kraocisë. Atyre ju kanë marrë sendet që posedonin si telefona apo para. Por për aq kohë sa kjo nuk dëshmohet, nuk mund t'u besosh vetëm migrantëve. Ne

kemi disa raste të dokumentuara, të personave që janë kthyer nga Kroacia pa rroba. Ne u kemi ndihmuar atyre në bashkëpunim me autoritetet ndërkombëtare.” - tregon Nermin Kljaji.

Gjendje e tensionuar dhe mes vetë migrantëve

Në kamp na konfirmojnë se gjendja është e tensionuar kohët e fundit edhe mes vetë migrantëve. Shumë prej tyre janë larguar prej kampeve duke qendruar në male dhe fusha në pritje për të gjetur rastin të kalojnë kufirin.

“Aktualisht ka po aq njerëz edhe jashtë kampit - madje ndoshta edhe më shumë. Tani po vjen dimri dhe moti po përkeqësohet, ndërkohë që një numër i madh i migrantëve ndodhen jashtë në të ftohtë. Nëse nuk ndërmerret diçka, ata do të përballen me një katastrofë humanitare, sepse njerëzit nuk kanë ushqime të mjaftueshme, e të mos flasim për kushtet higjienike.” - thotë Mite Cilkovski, punonjës i IOM-it në kampin „Miral”.

Migrantë maleve të Bosnje-Hercegovinës

Qendrat e migrantëve në Bosnje-Hercegovinë janë në gjendje të rëndë. Ndërsa organizatat humanitare dhe organet e sigurisë mendojnë se në malet rreth kufirit aktualisht ka rreth 2000-3000 migrantë.

Njëri prej tyre është edhe Muhammadi 18-vjeçar. Para pak ditësh ai ka ardhur këtu nga Sarajeva - më këmbë. Ai do të shkojë në Gjermani. „Ky është për mua opsioni i fundit, sepse në Pakistan nuk kam mundësi si në Evropë. Ndaj dua të jetoj në Evropë që të kem një jetë më të mirë, jetë më të mirë për familjen time, që ka mbetur në Paksitan. Vetëm kaq dua.” - thotë Muhammadi.

Moti është ende relativisht i mirë, por dimri është në prag. Nëse shpejt nuk gjendet ndonjë vendstrehim, këtu rrezikon një katastrofë humanitare, thotë drejtori i Misionit të OKB për migrantët në Bosnje-Hercegovinë, Peter Van der Auweraert: “Brenja ime më e madhe është, se nëse nuk gjejmë ndonjë vendstrehim tjetër, le të themi deri në fund të tetorit, njerëzit thjeshtë do të ngrinin nga të ftohtit dhe mund të vdesin jashtë. Ky do të jetë një realitet i hidhur.”

Lojë në duart e politikës boshnjake

Por tani për tani nuk ka konsensus për hapjen e ndonjë kampi të ri. Kjo ka të bëjë me strukturat e komplikuar politike të Bosnje-Hercegovinës. Qeveria në Sarajevë pret për ndonjë zgjidhje nga ana e BE-së. Duket që migrantët si Muhammadi, Zulqari dhe Abdurrahmani janë vetëm si lojë në duart e politikës boshnjake. Por dimri nuk pret deri sa të zgjidhen problemet politike në vend. Të ftohtit do t'i godasë ashpër migrantët. Kjo është e sigurtë. Asnjë prej tyre nuk dëshiron të mbetet këtu, ndaj ata po përpiqen të kalojnë kufirin kroat, me shpresë se një ditë do të mbërrijnë në Gjermani, Spanjë, Francë apo diku tjetër.

Mrika, malësorja që mori gjakun burrit, historia që u bë pjesë e një libri Best Seller në vitin 1909

Nga Albert Vataj

Natyrisht që keni dëgjuar shprehjen eufemike: “Ajo është një grua që të merr gjakun”, që do të thotë se është një grua trime dhe fisnike, grua që vjen nga derë e madhe, grua që është rritur dhe armatosur me parimet e larta të së drejtës dhe nderit. Bashkëshorti për të është i shtrenjtë, i barabartë me pjesëtarët e tjerë të familjes dhe përballë konflikteve dhe pasojave tragjike, ai nuk është i vetëm edhe kur duhet të kthehet nderi në vend nga një grua.

Marrja e gjakut nga një grua edhe pse nuk është e sanksionuar në formë detyruese në kodet zakonore të maleve, ky akt nuk gjendet e përjashtuar, ç’ka e legjitimon bërjen e drejtësisë duke kthyer nderin në vend, si në rastin e Mrikës që ka ardhur përmes “An observer in the Near East”, shkruar nga William LeQueux (2 korrik 1864-13 tetor 1927) shkrimtar i zhanrit e romancës, misterit, thrillerit dhe spiunazhit.

Në librin “Një vëzhgues në Lindjen e Afërt”, botuar në Londër, “T. Fisher Unwin”, në vitin 1907, një libër i ilustruar me fotografi, ai ndër të tjera shkruan për një grua dhe një ngjarje, që atij i ka rrëmbyer interesimin aq sa ta trajtojë dhe konsiderojë pjesë e pasqyrimin të tij krijues. Bëhet fjalë për Mrikën, e cila mori gjakun burrit. Edhe vetë tiparet e kësaj gruaje, përcjellë kaq besnikërisht në këtë foto, tregon hir dhe ashpërsi. Përmes vështrimit të saj shpues dhe qehres së vranët, autori i librit dhe fotografi, e ka ilustruar përsosmërisht historinë, duke mos e neglizhuar në këtë përcjellje imazhi edhe veshjen karakteristike shqiptare të malësore, stolit e saj dhe mënyra e pozimit.

“Aparati im fotografik, qysh në fillim u pa me shumë dyshim dhe pata vështirësi të madhe ta bindja secilin që t’i bëja fotografi.

Shumë fotografi të fshehta i kam bërë me një aparat fotografik të vogël “Broënie”, pasi për fat të keq i kisha mbaruar filmat për Kodakun e madh që kisha. Por, isha në gjendje që të siguroja disa fotografi, të cilat shfaqen në këtë vëllim. Një mëngjes herët, në të lindur të diellit, isha duke ecur me Lukën dhe Palokun, kur na kaloi para një grua e re.

“Kjo është Mrika e Kolë Marashit,” – tërhoqi vëmendjen Luka.

“Kush është ajo?” – pyeta.

“Mrika. Gruaja që mori gjakun”, – ishte përgjigjja e tij.

“Dy vjet të shkuara, ajo ishte vajza



MRIKA, the woman who carried on the blood-feud.

më e bukur e fisit tonë dhe kishte një duzinë burra, të gatshëm për t’u martuar me të. Ajo u martua me Lecin, një djalë të zgjuar i anës së Pulatit dhe një nga rojet e bajraktarit, njëllor si unë. Një muaj pas martesës, Leci u vra pabesisht nga i vëllai, i cili jetonte poshtë Drinit të Bardhë, ky i dashuruar marrëzisht me të. Kur ajo mori lajmin u shpërfytyrua nga pikëllimi. Por, me ngadalë thuri planet për gjakmarrjen dhe duke mos pasur asnjë të afërm të gjinisë mash-

kullore, zgjodhi ta merrte vetë gjakun. Kësisoj, na la dhe u zhduk për gati një vit, gjatë të cilit ajo ndoqi hap pas hapi kunatin e saj, në Ohër, në Maqedoni, pastaj në Shkup, Prizren dhe në shumë vende të tjera, duke pritur gjithmonë mundësinë për të kryer goditjen. Kjo ndodhi një pasdite, kur vrasësi i së shoqit po ecte në rrugën kryesore të Shkodrës dhe ajo, nxori koburen e Lecit nga brezi dhe ia shpërtheu atij tutje fytyrën. Trimëri për një grua, apo jo? Por, nuk mbaron me kaq,” –

vazhdoi ai.

“Me të vranë vrasësin, shkoi direkt në shtëpinë e prindërve të tij, pas një udhëtimi trefitor dhe i vrau që të dy. Që atëherë ajo është kthyer me ne, pasi vdekjes së të shkretit Lec iu mor haku. Më erdhi keq që ai vdiq, – shtoi ai me keqardhje, – sepse ishte një nga miqtë e mi më të dashur.”

Siç ju e dini, në kulturën tradicionale shqiptare, gjakmarrja është detyrimi shoqëror për të vranë një shkelës nderi ose një anëtar të familjes së tyre, për të shpëtuar nderin e fisit, për të qenë i papërgjatur nga komuniteti dhe i barabartë kah rregullat e asokohshme të së drejtës. Kjo praktikë përgjithësisht shihet si në përputhje me kodin shoqëror të njohur si Kanuni i Lekë Dukagjinit ose thjesht Kanuni, i përbërë nga 12 libra dhe 1262 artikuj ku ka rregulla të ndryshme. Kodi ishte fillimisht një “një kod jo-fetar që përdorej nga myslimanët dhe të krishterët njësoj”.

Mbrojtja e nderit është një komponent thelbësor i kulturës shqiptare sepse është thelbi i respektit shoqëror. Nderi mbahet në konsideratë shumë të lartë sepse përkthehet ndër breza. Amanetet dhe historia mbahen në emrat e shqiptarëve dhe duhen mbajtur në prioritet të lartë, edhe me çmimin e jetës. Prandaj, kur një sulm personal me përmasa të frikshme lëshohet ndaj një anëtari të çdo familjeje, duhet të pritet një dënim i barabartë nga ligjet e Kanunit. Disa nga veprimet që nisnin gjakmarrjen përfshijnë “vrasjen e një mysafiri ndërsa ai ishte nën mbrojtjen e të zotit të shtëpisë, shkeljen e pronës private, mospagimin e një borxhi, rrëmbimin ose joshjen ose përdhunimin e një gruaje.” Kjo shpesh zgjat shumë gjenerata nëse borxhi nuk paguhet. Ata që zgjedhin të mos paguajnë me jetën e familjarëve të tyre jetojnë në turp dhe izolim deri në fund të jetës, të burgosur në shtëpitë, e tyre duke pas hasmëri gjatë gjithë jetës me ata që ua kanë dhënë borxhin.

Rasti i Mrikës, gruaja që mori gjakun burrit, e sjellë me kaq origjinalitet nga William LeQueux në librin e tij, shoqëruar me foto, është i rrallë në Shqipëri, por jo vetëm. Është pikërisht kjo karakteristikë e veçantisë së kësaj ngjarjeje që ka arritur të jetësojë dhe të faktohet, duke mbetur një episod që e tregon shqiptarin si një identitet nacional që e konsideron sublime nderin dhe ligjësinë si një mjet që rregullon marrëdhëniet dhe ruan balancat në një realitet ku mungon shteti dhe mekanizmat ligjzbatuese.

Referuar:
mekulipress.com/mrika-gruaja-shqiptare-qe-mori-gjakun/
wikiwand.com/sq/Gjakmarrja
wikiwand.com/en/William_Le_Queueux

Nga Robert Elsie

Fotografët e parë në Shqipëri dhe në Jugperëndim të Ballkanit

Gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni në vjeshtë të vitit 1863, albanologu Johan Georg fon Han (Johann Georg von Hahn, 1811-1869) u shoqërua nga fotografi austriak Jozef Sekeli (Josef Székely, rreth 1838-1901), i cili thuhet se ka bërë ndër fotografitë më të hershme të Shqipërisë. Koleksioni i tij përfshin 50 fotografi, me pamje të Shkodrës, të Prizrenit, të Ohrit dhe të Manastirit.

Në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të njëzetë ishte dukuri e zakonshme për udhëtarët, shkencëtarët dhe albanologët në Shqipëri të merrnin në aparat fotografik me vete për të fotografuar vendin. Ky material, jo gjithmonë fotografi me cilësi të lartë, u shfrytëzua për të ilustruar librat e tyre për Shqipërinë. Disa koleksione nuk u botuan kurrë, dhe mbeten tani – një shekull më vonë – për t'u zbuluar.

Historia e fotografisë vendase në këtë rajon të Evropës juglindore, d.m.th. të fotografëve nga rajoni vetë, lidhet në mënyrë të veçantë me dy koleksione me famë.

Fototeka Marubi në Shkodër përfshin rreth 150.000 fotografi, shumë prej tyre me një rëndësi të dukshme historike, artistike dhe kulturore. U përpilua nga tre breza fotografësh. Pjetër Marubi (Pietro Marubbi, 1834-1903) ishte piktor dhe fotograf italian i cili, si përkrahës e Garibaldi, u detyruan të ikte nga Piacenza të Italisë për arsye politike dhe gjeti strehim në Shkodër rreth vitit 1850. Aty, themeloi dyqanin Foto Marubi me disa aparatë fotografikë që i kishte sjellë me vete. Fotografitë më të vjetra të koleksionit janë nga vitet 1858-1859. Disa foto të Marubit u botuan në revistat The London Illustrated Neës, La Guerra d'Oriente dhe L'Illustration. Marubi u ndihmua nga djali Rrok Kodheli (1862-1881) dhe nga vëllai i tij, Kel Kodheli (1870-1940), i cili më vonë, pas vdekjes së Pjetrit, e mori në trashëgim firmën familjare dhe u bë i njohur si Kel

Marubi. Keli mësoi të përdorte efekte të posaçme dhe të përpunonte negativat. Gjithashtu filloi të fotografonte jashtë studios me aparate më bashkëkohore.

Lidhur ngusht me familjen Marubi ishte fotografi dhe piktori Kolë Idromeno (1860-1939) i Shkodrës. Me mbështetjen e Pjetër Marubit, prej të cilit mësoi artin e fotografisë, ai shkoi në Venedik në vitin 1875 për të studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura. Ai nuk arriti të përfundonte mësimin dhe e braktisi Akademinë pas gjashtë muajve, mirëpo mbeti në Venedik dhe punoi disa vjet si ndihmës i një piktori venecian, për të kthyer në Shqipëri në vitin 1878. Në vitin 1883, Idromeno hapi një fotostudio me aparatë fotografikë të marrë nga shoqata Pathé në Francë. Në vitin 1912, importoi për herë të parë në Shqipëri aparate filmike dhe shfaqti filme. Në gusht të atij viti, firmosi një kontratë me shoqatën Josef Strauber në Austri për të krijuar atë që mund të quhet kinemaja e parë në Shqipëri.

Brezi i tretë i fotografëve Marubi ishte djali i Kelit, Gegë Marubi (1907-1984). Ai studioi në Lion të Francës në 1923-1927 pranë shkollës së parë të fotografisë dhe të kinemasë të themeluar nga vëllezërit Lymier, dhe punoi në Shkodër si fotograf nga viti 1928-1940. Ishte i pari në familje që përdori celuloid në vend të pllakave prej xhami.

Fotostudio Marubi kap dhe dokumenton historinë e Shqipërisë së Veriut që prej

Lidhjes së Prizrenit e mëtej. Përfshin fotografi të mahnitshme të udhëheqësve të fiseve të veriut, të kryengritjeve të malësorëve, të jetës qytetare në Shkodër dhe të ngjarjeve publike të ndryshme. Vetëm pak fotografi janë botuar deri tani. Që prej vitit 1994, me mbështetjen e UNESCO-s, bëhen përpjekje për të shpëtuar koleksionin dhe për ta bërë të njohur.


Koleksioni tjetër i njohur i fotografisë dhe të cinematografisë ballkanike është ai i vëllezërve Manakis në Maqedoni. Janaki Manakis (1878-1954) dhe vëllai Milton Manakis (1882-1964) lindën në fshatin Avdela afër Grevenës, tani në veri të Greqisë, dhe ishin me prejardhje vllahe (aromune). Nga 1898-1904 kishin një dyqan fotografik në Janinë dhe në vitin 1905 u vendosën në Manastir, tani në Republikën e Maqedonisë, ku hapën Studion për Artin Fotografik. Janaki dhe Milton Manakis bënë më shumë se 17.300 fotografi në 120 vende të ndryshme. Në vitin 1905 realizuan edhe filmin e parë në Ballkan.

Në Shqipëri janë edhe koleksionet e Shan Picit (me rreth 70.000 fotografi), të Dedë Jakovës (me rreth 50.000 fotografi) dhe të Raboshtës, të gjitha të lidhura ngushtë me shkollën e Marubit në Shkodër. Koleksione të tjera të rëndësishme të fotografisë së hershme ndodhen në Korçë. Ndër ato janë veprat e Petro Dhimitrit (1861-1946), i cili filloi si fotograf bredhacak në vitet 1890; të Kristaq Sulidhit,

i cili mësoi profesionin në Greqi; dhe të Vani Burdës të Bukureshtit i cili hapi një fotostudio në Korçë në vitet 1920. Me një interes të veçantë është vepra e Kristaq Sotirit (1883-1970) të Korçës, student i Sulidhit, i cili mërgoi në Shtetet e Bashkuara në 1902-1903 dhe punoi fotograf në Nju Jork dhe Los Anxheles. Në vitin 1923 u kthye në Korçë dhe, bashkë me piktorin e njohur korçar Vangjush Mio (1891-1957), hapi fotostudion Sotiri, të njohur në juglindjen e Shqipërisë. Janë ruajtur rreth 14.000 fotografi të këtij koleksioni. Mund të përmenden edhe Ymer Bali i Tiranës, Mandi Koçi (1912-1982) i Voskopojës, Jani Ristani i rrethit të Gjirokastrës, Misto Cici i Pogradecit dhe Xhimitiku i Beratit. Megjithatë nuk lidhet drejtpërsëdrejti me Shqipërinë, nuk duhet harruar në historinë e fotografisë shqiptare edhe emri i Gjon Milit (1904-1984), i cili mërgoi në Shtetet e Bashkuara në vitin 1923, studioi në Institutin e Teknologjisë të Masaçuset-it (Massachusetts Institute of Technology) dhe u bë i famshëm si fotograf për revista të njohura amerikane si Life dhe Fortune.

Kjo faqe <http://www.albanianphotography.net/index.html>

Kjo faqe interneti nuk synon të ofrojë një prezantim sistematik të fotografisë shqiptare. Ajo paraqet thjesht disa koleksione, deri tani kryesisht të panjohura, të fotografisë të hershme për Shqipërinë dhe për shqiptarët.



Fotomontazhi: Albert Vataj

GJYKATA E ARBITRAZHIT TIRANE



*"zgjidhni konfliktet tuaja ne menyre
profesionale - shpejt, drejt dhe pa
burokraci!"*

NE QOFTE SE KENI:

konflikte tregtare dhe financiare
mosmarreveshje nderkombetare
konflikte ndertimi dhe pasuri te paluajtshme
pronesi intelektuale dhe sigurime
partneritete biznesi dhe kontrata te furnizimit

OSE DESHIRONI:

formim dhe certifikim si arbiter -
regjistrohuni tani!



Contact us
+355692020512



Visit our website
gjkataarbitrazhit.com



Email us:
info@gjkytaarbitrazhit.com

